

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6550
E premte, 4 mars 2022
çmimi 0.40 €

Eurodeputetja Cramon konfirmon përkrahjen për liberalizimin e vizave

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KUVENDI I KOSOVËS MIRATON REZOLUTË NË MBËSHTETJE TË UKRAINËS

KOSOVA ME REZOLUTË DËNON AGRESIONIN RUS NË UKRAINË



Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të enjten një rezolutë në mbështetje të Ukrainës dhe popullit të saj në rezistencë ndaj agresionit rus. Rezoluta u miratua me 94 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Në kohën kur po votohej për rezolutën deputetët e Listës Serbe nuk kanë qenë të pranishëm në sallë

AKTUALE




ABAZOVIQI, MANDATAR I QEVERISË
SË RE NË MAL TË ZI F. 3

VAZHDON AKSIONI "BREZOVICA 3",
ARRESTOHEN SHTATË PERSONA F. 6

GRENELLI KËRKON LIRIMIN E
THAÇIT, GJYKATËS SPECIALE
I VJEN ERA POLITIKË F. 3


EKONOMI



VAZHDOHET EDHE PËR 30 DITË
GJENDJA EMERGJENTE PËR
FURNIZIM ME ENERGI ELEKTRIKE F. 8

OAK-U: BOJKOTONI PRODUKTET E
RUSISË DHE ALEATËVE TË SAJ F. 8

SPORT



RAHMANI PARA NDESHJES
NDAJ MILANIT: DUAM
TË MBAHEMI MEND SI HERONJ F. 8

Serbia po e vazhdon lojën: Është koha për samit të liderëve shqiptarë të rajonit!

FAQE 7



Shkruan: Valon MURATI



RUSIA PUSHTON QYTETIN KYÇ TË UKRAINËS JUGORE PAS NJË JAVE LUFTË

FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

UKRAINA, NJË JAVË QË NGA AGRESIONI I RUSISË

Rusia pushton qytetin kyç të Ukrainës jugore pas një jave luftë

Trupat ruse kanë pushtuar qytetin Herson, që shënon qytetin e parë të madh ukrainas që ra në një luftë shkatërruese njëjavore. Pushtimi i Hersonit erdhi pas një rrethimi treditor që e la këtë qytet pa ushqim dhe ilaçe dhe duke u përpjekur për të mbledhur dhe varrosur të vdekurit. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka theksuar se çdo pushtues do të kundërshtohet ashpër nga ukrainasit, ndërkaq në anën tjetër se Rusia do ta çmilitarizojë me sukses Ukrainën dhe do ta bëjë atë neutrale



në Evropë për një seri takimesh me NATO-n dhe aleatët e tjerë lidhur me përgjigjen e tyre ndaj agresionit rus në Ukrainë. Ministrat e Jashtëm të NATO-s do të mblidhen të premten në një takim të jashtëzakonshëm në Bruksel dhe të shtunën sekretari Blinken udhëton për në Poloni për të diskutuar për sigurinë dhe ndihmën humanitare për refugjatët që kanë ikur nga Ukraina.

Trupat ruse kanë pushtuar qytetin Herson, që shënon qytetin e parë të madh ukrainas që ra në një luftë shkatërruese njëjavore.

Marrja nën kontroll e qytetit prej 290 000 banorësh, i cili vetëm vitin e kaluar mbajti stërvitje luftarake të mbështetura nga NATO-ja, u pa si një nxitje e rëndësishme për Moskën.

Pushtimi i Hersonit erdhi pas një rrethimi treditor që e la këtë qytet pa ushqim dhe ilaçe dhe duke u përpjekur për të mbledhur dhe varrosur të vdekurit.

Fitorja e Moskës në Herson vjen një javë pasi ushtria e presidentit rus Vladimir Putin marshoi në Ukrainë nga veriu, lindja dhe jugu.

Forcat ruse kanë bombarduar në mënyrë sporadike objektiva civile anembanë vendit, duke përfshirë kryeqytetin Kiev dhe qytetin e dytë Harkiv, i cili tani po vihet nën sulme më intensive.

Sulmi i Moskës ndaj Ukrainës ka nisur në orët e para të 24 shkurtit.

Presidenti rus Vladimir Putin ka urdhëruar "operacion special" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Veprimi i Kremlinit ka nxitur zemërim dhe është dënuar në gjithë botën.

Shtetet e Bashkuara dhe aleatët janë përgjigjur me sanksione të ashpra kundër Moskës.



KIEV, 3 MARS - Ukraina ka shënuar të enjten një javë që nga fillimi i agresionit të Rusisë ndaj saj, ndërsa forcat ruse vazhduan bombardimin e qyteteve kryesore dhe numri i refugjatëve që u larguan nga Ukraina arriti në mbi 1 milion. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka postuar një videomesazh të ri për qytetarët, duke u kërkuar atyre që ta vazhdojnë luftën kundër pushtuesve rusë. Videoja e postuar në rrjetin social "Facebook" ka mbishkrimin: "Çdo pushtues duhet ta dijë: do të kundërshtohet ashpër nga

ukrainasit". "Ne jemi një komb që prishi planet e armikut brenda një jave. Ne i ndaluan ata", ka thënë Zelensky. Ai ka shtuar se ushtarakët rusë që janë kapur nga ukrainasit "nuk e dinë pse janë këtu" dhe se ushtarët e armikut "po ikin përsëri në Rusi". Ai ka thënë se trupat janë "fëmijë të hutuar", të cilët po "përdoren" nga udhëheqësit e tyre në Moskë. Zelensky ka falënderuar civilët në qytetet Konotop, Bashtanka, Energodar dhe Melitopol, të cilët ka thënë se kanë bllokuar rrugët për trupat ruse. Ai ka theksuar se së fundmi ka folur me liderët e Norvegjisë, të

Izraelit, të Kazakistanit, të Katarit, të Kanadasë, të Polonisë dhe të Këshillit Evropian.

Zelensky, gjithashtu, ka nënshkruar një dekret, përmes të cilit i shpalli heronj të Ukrainës 15 ushtarakë ukrainas, nëntë prej të cilëve kanë vdekur.

Presidenti rus, Vladimir Putin, i ka thënë homologut të tij francez, Emmanuel Macron, se Rusia do ta çmilitarizojë me sukses Ukrainën dhe do ta bëjë atë neutrale. Këto, sipas tij, janë qëllimet e tij për Ukrainën.


Sipas një skripte të bisedës telefonike, Putini ka thënë se çdo përpjekje për t'i vonuar negociatat do të rezultojë me një Rusi që zgjeron listën e kërkesave, ka raportuar "BBC". Putini, po ashtu, i ka thënë Macronit se nuk është pajtuar

me një fjalim që ka mbajtur ai një ditë më parë.

Në të Macroni ka thënë se Putini është përgjegjës për nisje të luftës.

Të enjten ka nisur edhe një raund i dytë i bisedimeve të paqes midis dy palëve, megjithëse ka pak shenja të një përparimi të mundshëm. Një takim fillestar të hënën përfundoi vetëm me plane për bisedime të mëtejshme.

Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, ka thënë se Shtetet e Bashkuara mbeten të hapura për të gjetur një zgjidhje diplomatike për situatën, por se Rusia së pari duhet t'i ulë tensionet ushtarake. "Është shumë më e vështirë për diplomacinë të ketë sukses kur armët shkrepn dhe tanket janë në lëvizje", u tha ai gazetarëve. Sekretari Blinken do të qëndrojë



Grenelli kërkon lirim të Thaçit, Gjykatës Speciale i vjen era politikë

PRISHTINË, 3 MARS - Ish-emisari amerikan për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, ka lavdëruar punën e ish-presidentit Hashim Thaçi në funksion të paqes. Grenelli ka thënë se vendimet e Thaçit sa ishte president kanë qenë të mira. Në këtë kontekst ai ka folur edhe për kohën kur Thaçi ishte nisur për në Uashington në vitin 2020 për nënshkrimin e marrëveshjes në ShBA, por ishte kthyer në rrugë për shkak të aktakuzës nga Gjykata Speciale. Grenelli ka thënë se mënyra se kishte ndodhur kjo gjë ishte e tmerrshme. Më tutje, Grenelli u ka bërë thirrje përfaqësuesve perëndimorë që ta nxjerrin Thaçin nga burg, duke thënë se Gjykatës Speciale i "vjen era politikë".

Sipas Grenellit, akuza ndaj Thaçit është e paqartë. "Po, mendoj se është e tmerrshme që të ndalohesh në këtë mënyrë. Nuk e di se çfarë ndodhi me siguri, por ajo që mund të them është se në atë pikë të negociatave Thaçi kishte marrë vendime të mira për ta vendosur paqen. Ishin vendime të mira, por edhe të shpra. Ishim në rrugën e duhur. Pas më shumë se 20 vjetësh, gjykata ndërkombejtare (Gjykata

Speciale) nxori diçka, por momenti kur e bën ishte skeptik dhe i tmerrshëm. Bota perëndimore duhet t'i kthejë sytë pas dhe të thotë: 'Diçka nuk po shkon. Dikush është duke luajtur me politikën'. Do të bëja thirrje për çdo përfaqësues perëndimor, qeveri, agjenci për të punuar fort dhe për ta nxjerrë Thaçin nga burg. Është e papranueshme që ta mbash në qeli kaq gjatë, pa akuza të qarta", ka thënë Grenelli në një intervistë për emisionin "Opinion" të Blendi Fevziut.

I pyetur nga Fevziu që ta komentojë procesin gjyqësor ndaj Thaçit dhe të tjerëve ku flitet se mund të zgjasë deri në 10 vjet, Grenelli ka thënë se një gjë e tillë nuk duhet të lejohet. "Është e tepërt që komuniteti ndërkombejtare e lejon të vazhdojë një gjë e tillë. Nuk e di pse po e lejon Uashingtoni, Berlioni, Parisi apo Brukseli. Është e papranueshme të dënosh dikë me burgim pa pasur akuza shumë specifike. Dhe kjo gjë ndodhi pas 20 vjetësh, kur ai po shkonte për të nënshkruar një marrëveshje. Vjen era politikë", është shprehur Grenelli.

Në këtë intervistë Grenelli ka folur edhe për idenë e



shkëmbimeve të territoreve, dialogun, qeverinë Kurti dhe luftën në Ukrainë.

Sa i përket shkëmbimit të territoreve, ai ka thënë se në takime më të askush nuk e ka diskutuar këtë temë. "Kurrë nuk kam dëgjuar njeri që ta përmendë shkëmbimin e territoreve në praninë time. Ishte e papranueshme si për mua ashtu edhe për presidentin

Trump. E di që ka mjaft akuza, por nuk di të them nëse është e vërtetë. Ajo që di është se Donald Trump nuk ka qenë kurrë pro shkëmbimit të territorit. Kjo çështje s'i është parashtruar atij", ka deklaruar Grenelli.

Kurse duke folur për kryeministrin Albin Kurti, ka thënë se kurrë nuk e ka kuptuar për refuzimin e gazsjellësit amerikan. "Në mënyrë

thelbësore refuzimi i një ideje amerikane për energji te pastër është shumë problem. Nuk mendoj se ka shumë raste kur Kurti shtyn para politika për të cilat qeveria amerikane mund të jetë dakord. Ai sikur po kthen pas shumë progres që është bërë", ka thënë Grenelli, duke shtuar se populli i Kosovës është kundër refuzimit të këtij projekti amerikan.

Abazoviqi, mandatar i qeverisë së re në Mal të Zi

PODGORICË, 3 MARS - Presidenti i Malit të Zi, Milo Gjukanoviç, ka propozuar liderin e Lëvizjes Qytetare URA, njëherësh ish-zëvendëskryeministër, Dritan Abazoviç, për mandatar të Qeverisë së 43-të të Malit të Zi. "Përfaqësuesit e Lëvizjes URA dhe partnerët e tyre politikë më kanë bindur ta mëdyshje se kanë shumicë parlamentare për zgjedhjen e Qeverisë së Malit të Zi në Parlamentin e Malit të Zi. I bindur se është në interesin më të mirë të Malit të Zi që sa më shpejt të jetë e mundur qeveria me kapacitet të plotë, veçanërisht për shkak të sfidave shtesë të sigurisë dhe politike të krijuara nga lufta në Ukrainë dhe reflektimi i saj në stabilitetin e rajonit tonë, pres që parlamenti të mbajë një seancë dhe të vendosë për programin dhe përbërjen e qeverisë me propozimin e mandatarit", thuhet në deklaratën e Gjukanoviçit.

Presidenti Gjukanoviç ka zhvilluar konsultime me përfaqësuesit e partive parlamentare të cilave nuk iu përgjigjën partitë e shumicës së mëparshme qeverisë, Fronti Demokratik pro-Serb (DF), Mali i Zi Demokratik

(Demokratët) dhe Partia Popullore Socialiste (SNP).

Partitë kombëtare të pakicave kanë gjetë konsultime me Gjukanoviçin se e mbështesin qeverinë e pakicës, ndërsa socialdemokratët kanë thënë se do të mbështesnin "çdo qeveri me mendje evropiane" dhe ishin të gatshëm jo vetëm ta mbështesin atë, por edhe të marrin pjesë në të.

Pas bisedimeve me Gjukanoviçin më 25 shkurt, lideri dhe deputeti i Partisë Socialdemokrate (SDP), Rashko Konjeviç, tha se Malit të Zi i duhet një qeveri e qëndrueshme me prioritet të qarta dhe jo një eksperiment i ri politik, i ngjashëm me qeverinë në largim të Zdravko Krivokapiçit.

URA dhe lideri i saj, Dritan Abazoviç, po kërkojnë formimin e një qeverie të pakicës, e cila do të përfshijë, përveç URA-s, partitë kombëtare të pakicave të shqiptarëve dhe boshnjakëve dhe SNP-në pro-serbe. Mbështetje në parlament pritet të marrin edhe nga partia e Gjukanoviçit dhe dy partitë e tjera socialdemokrate.

Më pak se një muaj pas rënies



së Qeverisë së Krivokapiçit, SNP-ja nuk ka vendosur nëse do të marrë pjesë në qeverinë e Dritan Abazoviçit.

Fronti Demokratik dhe Demokratët kërkojnë formimin e një qeverie teknike për organizimin e zgjedhjeve. Ata e konsiderojnë konceptin e

qeverisë së pakicave si "tradhti" ndaj vullnetit elektoral të votuesve në zgjedhjet e gushtit 2020, prandaj në Podgoricë dhe qytete të tjera malazeze po organizojnë protesta dhe bllokada duke kërkuar zgjedhje të reja. Ata e akuzojnë URA-n dhe Abazoviçin për

marrëveshje politike me Partinë Demokratike të Socialistëve (DPS) të presidentit Gjukanoviç.

Protestat nisën në fund të janarit të këtij viti, në prag të rënies së Qeverisë së Zdravko Krivokapiçit, së cilës i është dhënë mosbesimi më 4 shkurt.



KUVENDI I KOSOVËS MIRATON REZOLUTË NË MBËSHTETJE TË UKRAINËS

Kosova me rezolutë dënon agresionin rus në Ukrainë

Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të enjten një rezolutë në mbështetje të Ukrainës dhe popullit të saj në rezistencë ndaj agresionit rus. Rezoluta u miratua me 94 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Në kohën kur po votohej për rezolutën deputetët e Listës Serbe nuk kanë qenë të pranishëm në sallë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 MARS - Me 94 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi i Kosovës e ka miratuar rezolutën me të cilën e dënon agresionin ushtarak dhe invazionin e Federatës Ruse mbi Ukrainën dhe popullin e saj.

Me mesazhin "Ne jemi me Ukrainën", dhe një minutë heshtje për t'i nderuar viktimat e luftës atje, deputetët e Kuvendit të Kosovës e nisën seancën dhe e dënuan agresionin rus në Ukrainë.

Në kohën kur po votohej për rezolutën deputetët e Listës Serbe nuk kanë qenë të pranishëm në sallë.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka thënë se populli i Kosovës qëndron përkrah popullit të Ukrainës.

Ndërkaq kryeministri Albin Kurti ka thënë se sulmi ndaj Ukrainës është sulm mbi botën e civilizuar, sulm mbi lirinë dhe demokracinë. "Ne jemi popull paqedashës e liridashës, prandaj edhe e gjejmë veten edhe në

heroizmin e tyre për të luftuar për lirinë dhe vendin e tyre, sepse ne njohim mirë çmimin e lartë të lirisë", ka shtuar ai.

Në fjalën e tij kryeministri ka theksuar se Kosova tashmë ka dënuar ashpër sulmin e Rusisë ndaj Ukrainës. "Kemi miratuar sanksionet duke iu bashkuar

Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian; kemi marrë vendimin që të pranojmë 20 gazetarë nga Ukraina në mënyrë që edhe t'u ofrojmë strehim e siguri, por edhe kushte për punë, dhe sot së bashku miratohet kjo rezolutë në institucionin më të lartë të

Republikës sonë për ta dënuar agresionin rus. Ne kemi dënuar dhe dënojmë fuqishëm agresionin rus. Ne e dënojmë edhe mosdënimin e agresionit rus nga fqinji ynë verior Serbia dhe mosvënien e sanksioneve. Ndaj agresionit të Rusisë e pushtimit të Ukrainës nuk mund të ketë neutralitet për vende candidate për anëtarësim në Bashkim Evropian kur i gjithë Bashkimi Evropian e dënon dhe e sanksionon fuqishëm", ka deklaruar Kurti.

Shefja e Grupit Parlamentar e Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se "skenari i agresionit rus ndaj Ukrainës sot ka të njëjtën frymë sikur skenari i gjenocidit të Sllobodan Millosheviqit në Ballkan". Ajo ka shtuar se sot vlerat evropiane po mbrohen në një shtet, i cili ende nuk është anëtar i NATO-s dhe BE-së. "Në Ukrainë po derdhet gjak për t'u mbrojtur Evropa dhe liria", ka thënë ajo.

Kusari-Lila ka theksuar se forcat politike në Kuvendin e Kosovës janë bërë bashkë për t'i dërguar mesazhin botës se "ne jemi demokratët dhe evropianët, të cilët pa hamendje me zemër të hapur dërgojmë mbështetje pa rezervë ndaj një populli që ballafaqohet me brutalitetin dhe agresionin rus". Ajo ka paralajmëruar se me anë të rezolutës i jepet mbështetje Qeverisë së Kosovës për bashkërendim të mëtutjeshëm me masat dhe sanksionet ndaj Rusisë dhe Bjellorusisë: "Konfirmojmë vullnetin dhe mbështetjen tonë në ndihmë popullit dhe shtetit të Ukrainës përmes një fondi të veçantë dhe përgatitjes për të pranuar refugjatë nga ky shtet".

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se agresioni rus ndaj Ukrainës nuk e cenon vetëm sovranitetin e një shteti të



Eurodeputetja Cramon konfirmon përkrahjen për liberalizimin e vizave

Raportuesja për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon - Taubadel, gjatë vizitës së saj në Prishtinë ka rikonfirmuar përkushtimin e saj për ta ndihmuar Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave, integrimin në familjen e Bashkimit Evropian dhe në strukturat euroatlantike

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 MARS - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, i shoqëruar nga nënkryetarja Saranda Bogujevci dhe këshilltarët e kabinetit, ka prituri të enjten në takim raportuesen për Kosovën në Parlamentin Evropian, Viola von Cramon - Taubadel, e shoqëruar nga bashkëpunëtorët dhe shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. Konjufca ka shprehur mirënjohje për kontributin e eurodeputetes von Cramon si një zë i fuqishëm në PE për perspektivën evropiane të

Kosovës dhe mbështetjen e vazhdueshme të BE-së. Ai ka theksuar se Kosova tashmë i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara për liberalizimin e vizave, duke kërkuar nga institucionet e BE-së përmbylljen sa më parë të këtij procesi dhe lëvizjen e lirë për qytetarët e vendit tonë. Situata e sigurisë në Ballkanin Perëndimor përballë zhvillimeve në Ukrainë ishte një ndër temat e diskutimit në takimin e kryetarit Konjufca me eurodeputeten von Cramon. Në këtë kontekst, kryetari i Kuvendit tërhoqi vëmendjen se Republika e Kosovës në vazhdimësi ka dëshmuar rreshtimin përkrah



Perëndimit dhe përkushtimin e paluhatshtëm ndaj vlerave të përbashkëta euroatlantike. Sipas tij, anëtarësimi i përsheptuar i Kosovës në BE dhe në NATO do t'i shërbente jo vetëm sigurisë

rajonale dhe evropiane, por edhe asaj globale, e rrezikuar seriozisht nga pushtimi i paprovokuar rus i Ukrainës. Ndërkaq eurodeputetja von Cramon ka konfirmuar

përkushtimin e saj për ta ndihmuar Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave, integrimin në familjen e Bashkimit Evropian dhe në strukturat euroatlantike.



pavarur, parimet ndërkombëtare, por edhe vlerat demokratike dhe perëndimore, "me të cilat Kosova jeton pandashëm". Ai i bëri thirrje Qeverisë së Kosovës të ofrojë mbështetje konkrete për Ukrainën dhe qytetarët e saj, siç është ndarja e një fondi të veçantë dhe, në rast nevojë, ta mundësojë strehimin e 5 000 refugjatëve. "Ne e dimë çka do të thotë një eksod i tillë", ka theksuar Krasniqi.

Përkrahje popullit të Ukrainës i ka dhënë edhe LDK-ja. Lumir Abdixhiku, kryetar i kësaj partie dhe deputet, ka theksuar se në Ukrainë po mbrohen themelet e shtetit dhe vlerat njerëzore, lirisë, demokracisë. "Me këto vlera është e lidhur edhe Kosova...", ka thënë Abdixhiku. Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se Kosova qëndron përkrah shteteve demokratike, me ShBA-në, BE-në dhe Ukrainën. "Bota

demokratike e di se agresorët janë kundër vlerave tona të përbashkëta dhe gjithmonë do të dalin humbës", ka thënë Tahiri. Ndërkaq Igor Simiq nga Lista Serbe ka thënë se situata në Evropën Lindore ishte e tmerrshme dhe se lufta nuk i solli askujt asgjë të mirë dhe u bëri thirrje të gjithëve të tregohen të përbajtur. Ai u bëri thirrje të gjithë përfaqësuesve politikë që t'i peshojnë

deklaratat e tyre për të mos rrezikuar paqen. "Tensionet nuk duhet të ushqehen nga deklarata të papërgjegjshme, veçanërisht këtu në Ballkan. Ballkani duhet të qëndrojë larg të gjitha këtyre ngjarjeve sepse, më në fund, duhet të kuptonim se paqja nuk ka çmim, se qytetarët tanë nuk duan tensione dhe konflikte, por prosperitet", ka thënë Simiq. Më 24 shkurt forcat ushtarake të Federatës Ruse kanë nisur

pushtimin e Ukrainës. Shteti rus kundërshton integrimin e Ukrainës në Bashkimin Evropian dhe në NATO. Perëndimi i ka dënuar ashpër veprimet e Rusisë, duke i cilësuar si shkelje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Ukrainës. Rusisë i janë vendosur një sërë sanksionesh nga shtetet perëndimore. Sanksione ndaj Rusisë më 25 shkurt ka vendosur edhe Kosova.

Të shtunën testohet alarmi publik në Prishtinë

PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Komuna e Prishtinës ka njoftuar qytetarët se të shtunën do ta bëjë testimin e

radhës të sistemit të alarmit publik në Prishtinë. Testimi do të bëhet në orën 12:05, me tingull të njëtrajshëm dy

herë nga 30 sekonda. “Këtë të shtunë, më 5 mars, në orën 12:05, komuna e Prishtinës do ta bëjë testimin e radhës

të sistemit të alarmit publik me tingull të njëtrajshëm dy herë nga 30 sekonda”, është thënë në njoftim.



Prizreni dhe Suhareka bashkëpunojnë me UNDP-në dhe ADA-në për klimën

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRIZREN, 3 MARS (ER) - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë, i mbështetur nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), njësia operative e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim në Kosovë, dhe komuna e Prizrenit dhe ajo e Suharekës kanë lansuar projektin “Fuqizimi i veprimit lokal për klimën” (SLCA) i cili synon t’i zvogëlojë emetimet e gazeve serrë (GS) dhe të kontribuojë në përsheptimin e tranzicionit të gjelbër.

Lansimi i këtij projekti u bë në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren.

Niels Knudsen, zëvendësperfaqësues i përhershëm i UNDP-së, ka thënë se ndryshimet klimatike janë sfida përcaktuese globale që mund të trajtohen në mënyrë efektive vetëm nëse ndërmerret veprime të fuqishme në nivel lokal. “Për më shumë se një dekadë, UNDP-ja me partnerë ka mbështetur Kosovën që të ndërmerret veprime klimatike



dhe të ndërtojë qëndrueshmëri të komunitetit”, ka thënë ai.

Sandra Horina, shefe e Agjencisë Austriake për Zhvillim (ADA), njësia operative e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim në Prishtinë, ka theksuar se është përgjegjësi kolektive dhe individuale të ruajmë dhe të kujdesemi për botën në të cilën jetojmë të gjithë. “Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet

më urgjente mjedisore të kohës sonë është më e rëndësishme se kurrë. Me këtë projekt ne synojmë t’i zvogëlojmë emetimet e gazeve serrë dhe të kontribuojmë në zhvillimin neutral ndaj karbonit përmes një qasjeje të integruar dhe të ndjeshme ndaj gjinisë. Pikësynim do t’i kemi së paku 620 përfitues të drejtpërdrejtë nga institucionet publike dhe sektori privat nga të cilët të

paktën 340 do të jenë gra përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe aktivitete ndërgjegjësuese”, është shprehur Horina. Shaqir Totaj, kryetar i komunës së Prizrenit, ka theksuar rëndësinë e këtij projekti. “Komuna e Prizrenit do të angazhohet me të gjitha kapacitetet që ka për ta arritur implementimin e projektit dhe, gjithashtu, funksionimin e tij në periudhë kohore afatgjatë. Ne

jemi të bindur se mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm i qytetit dhe zonave rurale është jashtëzakonisht i rëndësishëm”, ka thënë ai.

Mihrije Suka, nënkryetare e komunës së Suharekës, ka thënë se komuna e Suharekës dhe qytetarët e saj kanë mirëpritur fillimin e zbatimit të projektit: “Fuqizimi i veprimit lokal për klimën”. Projekti fuqizimi i veprimit lokal për klimën do të zbatohet në komunën e Prizrenit dhe të Suharekës. Qëllimi i projektit është t’i mbështesë komunat në tranzicionin e tyre drejt rrugëve të zhvillimit me emetim zero dhe kalimin në dinamikat e zhvillimit të qëndrueshëm urban-rural.

Kontributi i ADA-së në projektin “Fuqizimi i veprimit lokal për klimën” është një milion euro me bashkëfinancim të komunës së Prizrenit me 100 000.00 euro dhe komunës së Suharekës me 50 000.00 euro si dëshmi dhe përkushtim për të punuar së bashku për promovimin e zhvillimit rural dhe luftimin e ndryshimeve klimatike në nivel lokal.


Vazhdon aksioni “Brezovica 3”, arrestohen shtatë persona

FERIZAJ, 3 MARS (ER) - Me urdhër të Prokurorisë Themelore në Ferizaj dhe në bashkëpunim me Policinë e Kosovës ka vazhduar aksioni “Brezovica 3”, ku janë bastisur 12 lokacione të ndryshme në katër qytete të ndryshme, përkatësisht: Ferizaj, Prishtinë, Skenderaj dhe Lipjan.

Deri më tani janë arrestuar shtatë persona, tre prej tyre ish-zyrtarë të Ministrisë së

Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe katër pronarë të kompanive ndërtimore, të cilët dyshohen për keqpërdorim të detyrës zyrtare, marrje, dhënie të rryshfetit, si dhe ushtrim i ndikimit.

Prokuroria Themelore në Ferizaj do t’u mbajë të informuar me kohë për të gjitha zhvillimet e tjera rreth këtij aksioni.



Barnatoret në qytetin e Rahovecit respektojnë vendimin dhe orarin e kujdestarisë



Rahovec, 3 mars (ER) - Drejtoresha për Inspeksion në komunën e Rahovecit, Nora Boshnjaku, e shoqëruar edhe nga Inspektori i Tregut, Valon Hoti, kanë inspektuar

barnatoren “Green Pharmacy”, e cila ka qenë kujdestare gjatë natës së mërkurë, prej orës: 22:00 deri në 07:00. “Vendimi dhe orari i kujdestarisë për barnatoret në

qytetin e Rahovecit po zbatohet. Bashkë me Inspektorin e Tregut inspektuam barnatoren ‘Green Pharmacy’, e cila po kujdestaron sonte prej orës

22:00 deri në 07:00. Do të vazhdojmë të mbetemi të përkushtuar që vendimi mbi kujdestarinë e barnatoreve të zbatohet në vazhdimësi”, ka thënë drejtoresha Boshnjaku.

69 raste të reja me Covid në Kosovë

PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se nga 1 552 testime, 69 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit nuk është shënuar

asnjë rast i vdekjes. Të enjten janë shëruar edhe 99 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 221 778.

Në total numri i rasteve aktive me Covid është 1 567.

Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e fundit janë dhënë 535 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 814 540 doza të

vaksinës. Deri më sot 816 688 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë.

Deri më sot janë dhënë 97 857 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.



Serbia po e vazhdon lojën: Është koha për samit të liderëve shqiptarë të rajonit!



Shkruan: Valon MURATI

Votimi i Serbisë mbrëmë (të mërkurën) për rezolutën e AP të OKB-së për ta dënuar agresionin rus mbi Ukrainën kishte dy qëllime. E para për të bërë përpjekje që të paraqitet 'konsistente' në parimin e ruajtjes së parimit të integritetit dhe sovranitetit territorial dhe indirekt për ta krahasuar agresionin rus mbi Ukrainën me ndërhyrjen e

NATO-s në Kosovë. E dyta ta zbusë zemërimin e Perëndimit për shkak të mosvendosjes së sanksioneve ndaj Rusisë. Në anën tjetër, Serbia vazhdon me këmbëngulësi në politikën e saj për të mos u bërë pjesë e sanksioneve kundër Rusisë, që vazhdon ta vendosë në pozitë të palakmueshme sidomos me detyrimin që ka

në kuadër të procesit të anëtarësimit të saj për ta harmonizuar politikën e saj të jashtme me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë së BE-së. Kosova dhe faktori shqiptar duhet me kujdes të shtuar t'i përcjellin veprimet e politikës serbe, por të mos obsesionohet me të e aq më pak të frikësohet prej saj. Ne duhet ta

shfrytëzojmë rastin që në funksion të paqes dhe stabilitetit në rajon, por edhe zhvillimit tonë të brendshëm ta forcojmë pozicionin tonë duke dinamizuar bashkëpunimin me aleatët perëndimorë e duke koordinuar veprimet me faktorin shqiptar në rajon. Është koha për një samit të liderëve shqiptarë të rajonit.

Përmbillet procesi i intervistimit të kandidatëve për prokurorë të Shtetit



PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Këshilli Prokurorial i Kosovës ka përmblytur intervistimin e tetë kandidatëve në kuadër të procesit të rekrutimit në nivel të prokurorive themelore, proces ky i cili ka nisur në qershor të vitit

2020 dhe ka vazhduar me rishpalljen e tij në maj të vitit 2021.

Komisioni për Rekrutimin e Prokurorëve është përbërë nga pesë anëtarë të Këshillit Prokurorial dhe është kryesuar

nga Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ndërsa pas përmblyljes së këtij procesi ky komision do t'i propozojë Këshillit Prokurorial të Kosovës për votim kandidatët e suksesshëm.

Me këtë rast janë respektuar të gjitha afatet ligjore të zhvillimit të procedurave rekrutuese dhe janë zbatuar standardet profesionale, gjë që përbëjnë një proces të drejtë dhe transparent të vlerësimit të integritetit personal

dhe aftësive profesionale të secilit kandidat.

Rrjedhimisht, procesi i intervistimit të kandidatëve është monitoruar nga partnerët ndërkombëtarë dhe shoqëria civile.

Policia me dron po monitoron komunikacionin

FERIZAJ, 3 MARS (ER) - Të enjten në rajonin e Ferizajt Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor ka nisur kontrollimin e komunikacionit përmes dronit të policisë, aksion ky që do të vazhdojë përgjatë gjithë muajit mars në rrugët magjistrale, rajonale dhe

lokale të rajonit të Ferizajt. Aksioni i policisë ka për qëllim identifikimin e kundërvajtjeve të ndryshme në komunikacion, me theks të veçantë kundërvajtjet si: tejkalimi në vijë të plotë, kyçjet e pasigurta në rrugë, tejkalimin e shpejtësisë,

përdorimi i telefonit, mospërdorimi i rripit të sigurisë dhe kundërvajtje të tjera që shoferët me veprime të tilla mund të shkaktojnë aksidente në komunikacion. Drejtoria Rajonale e Policisë në Ferizaj ka ftuar qytetarët të bashkëpunojnë me policinë.



Buxheti i Ushtrisë së Kosovës ndër vite, nga 19 milionë deri në 100 milionë euro

PRISHTINË, 3 MARS - E formuar në vitin 2009, pas shpërbërjes së Trupave Mbrojtëse të Kosovës, me mbi 6 ushtarë aktivë dhe 3 500 rezervistë, Forca e Sigurisë së Kosovës në vitin e parë kishte pasur buxhet rreth 19 milionë euro. Katërmbëdhjetë vjet pas themelimit kjo forcë tashmë ka rreth 100 milionë euro buxhet. Më 15 shtator 2009 FSK-ja filloi zyrtarisht punën, me kapacitetet fillestare operacionale pas një trajnimit tetëmuajor me instruktorë të Aleancës Veriatlantike (NATO), shkruan "Telegrafi". Në vitin 2009 buxheti i FSK-së ishte 18 milionë e 819 mijë e 805 euro. Vetëm një vit pas, buxheti ishte rritur në 41 milionë e 217 mijë e 414 euro. Gjatë 2011-s ky buxhet kishte rënie për më pak se 5 milionë euro, pra ishte 36 milionë e 427 mijë e 707 euro. Për tre vite me radhë ky buxhet nuk kishte arritur të kalonte vlerën prej 40 milionë eurosh. Në vitin 2012 buxheti ishte 38 128 678 euro, në vitin 2013 në 34 500 743 euro, kurse gjatë 2014-s ishte qenë 38 507 738 euro. Për katër vitet e ardhshme buxheti i FSK-së ishte rritur për rreth 10 milionë euro më shumë. Nga 41 milionë e 358 mijë e 830 euro që ishte në vitin 2015, ishte shtuar në 49

milionë e 729 mijë e 407 euro në vitin 2018. Në vitin 2016 buxheti ishte 45 114 912 euro, kurse më 2017 ka arritur në 47 milionë euro 638 mijë e 627 euro. Më 18 tetor 2018 Kuvendi i Kosovës miratoi ta shndërrojë Forcën e Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës, pasi 98 nga 120 deputetët votuan pro transformimit. Në vitin e parë të shndërrimit Forcës së Armatosur i ishte ndarë një buxhet prej 54 milionë e 574 mijë e 838 eurosh. Një vit më vonë ky buxhet ishte rritur për rreth 10 milionë euro, duke arritur në 63 milionë e 665 mijë e 095 euro, kurse në vitin 2021 buxheti ishte 61 124 266 euro. Në buxhetin e vitit 2022 Forcat e Armatosura të Kosovës do të kenë 97 milionë e 217 mijë e 42 euro buxhet.

Formimi i Fondit të Sigurisë

Kryeministri Albin Kurti ka njoftuar se është themeluar Fondi i Sigurisë, duke i ftuar qytetarët e Kosovës, mërgatën dhe donatorët e tjerë të kontribuojnë për sigurinë e vendit. Kurti ka thënë se "në përputhje me nevojat e Forcave të Sigurisë së Kosovës, situatës aktuale dhe pas konsultimeve me partnerët




ndërkombëtarë, kam autorizuar Ministrinë e Financave për themelimin e Fondit të Sigurisë". "Mjetet e mbledhura financiare synohet të përdoren në përputhje me strategjinë e sigurisë shtetërore të Republikës së Kosovës që pritet të miratohet nga Qeveria e Republikës se

Kosovës. Funksionimi i këtij fondi do të rregullohet me akte përkatëse procedurale dhe do të përdoret ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar nga qeveria", ka deklaruar Kurti. Po ashtu, ai ka thënë se "në përputhje me legjislacionin në fuqi do të zbatohen procedurat për

prejardhjen e mjeteve financiare me qëllim të ruajtjes së integritetit të fondit dhe qëllimit të tij". "Ftohen qytetarët e Kosovës dhe bashkatdhetarët tanë në diasporë, por edhe donatorë të tjerë, të kontribuojnë për sigurinë shtetërore", ka përfunduar ai.

Vazhdohet edhe për 30 ditë gjendja emergjente për furnizim me energji elektrike



PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Me 61 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë përkrahur zgjatjen e masave emergjente për furnizim me energji elektrike. Ministria e Ekonomisë, Artan Rizvanolli, ka theksuar se rritja e çmimit të energjisë po vazhdon të ngrihet për shkak të agresionit rus ushtarak në Ukrainë. "Prodhimi i energjisë është më stabil, mirëpo vjetërsia e termocentralit 'Kosova A' dhe

'Kosova B' konsiderohet rrezik për furnizim me energji. Çmimet vazhdojnë të rriten në bursë. Këto çmime vazhdojnë të rriten për shkak të agresionit rus në Ukrainë. Kërkoj miratimin e masave emergjente në sektorin e energjisë", ka thënë Rizvanolli. Qeveria e Kosovës në mbledhjen e 62-të ka marrë vendim që të zgjatet edhe për 30 ditë gjendja emergjente e furnizimit të energjisë elektrike në vend.

Në fund të vitit të kaluar Kuvendi kishte miratuar vendimin e qeverisë për ta shpallë emergjente gjendjen me energji elektrike, e cila do të vlente për 60 ditë. Sipas dokumentit të publikuar nga Zyra e Kryeministrit, masat emergjente në furnizim me energji përfshijnë vendosjen e kufizimeve në furnizim me energji për konsumatorët dhe vendosjen e obligimeve të veçanta për ndërmarrjet e energjisë.

OAK-u: Bojkotoni prodhimet e Rusisë dhe aleatëve të saj

PRISHTINË, 3 MARS (ER) - Oda e Afarizmit e Kosovës (OAK) i bashkohet fushatës Botërore, Evropiane dhe të Republikës së Kosovës për mbështetjen e Ukrainës, duke u kërkuar bojkotimin e prodhimeve atyre që janë duke kryer gjenocid ndaj popullit të Ukrainës dhe atyre që janë duke e

përkrahur Rusinë siç është Serbia, duke kërkuar nga BE-ja, ShBA-ja dhe vendet e tjera, vendosjen e sanksioneve edhe për Serbinë. OAK-u kërkon nga bizneset që bëjnë tregti me Serbinë që ta ndërpresin menjëherë bashkëpunimin duke marrë parasysh pretendimet e

vazhdueshme dhe në rritje territoriale që Serbia me përkrahjen e Rusisë i ka ndaj Republikës së Kosovës, duke vazhduar ta mbajë në Kushtetutën e Serbisë ende Republikën e Kosovës. "Serbia është i vetmi vend në Evropë që nuk i ka vendosur Rusisë sanksione duke e konsideruar aleatin kryesor

të saj. OAK-u mbështet iniciativat nga Evropa dhe ShBA-ja dhe kërkon nga Qeveria e Kosovës që ta rrisë angazhimin që Bashkimi Evropian dhe ShBA-ja t'i përshpejtojnë procedurat për futjen e Kosovës në BE dhe NATO, si një garanci për rritjen e sigurisë në Ballkan dhe Evropë dhe shuarjen e

pretendimeve të Serbisë dhe Rusisë për ndarjen e Kosovës dhe Bosnjës. OAK-u që nga themelimi është në përpjekje të vazhdueshme të mbështetjes së bizneseve, sidomos atyre prodhuese në mënyrë që t'i zëvendësojë produktet e Serbisë me ato vendore", është thënë në reagimin e OAK-ut.

Ja si shërbimet sekrete ruse e gënjyen Vladimir Putinin



Nga Stefano VESPA
"Formiche.net"

Një raport i "The Royal United Services Institute" (RUSI), një think-tank i njohur në Britaninë e Madhe, shpjegon se çfarë ndodhi me Putinin, bazuar në dokumentet origjinale të inteligjencës ruse, të vëna në dispozicion nga autoritetet ukrainase.

Vendimi për pushtimin e Ukrainës, u mor në bazë të një studimi të kryer javët e fundit, por që fotografoi një realitet në kohë paqeje, pa analizuar nëse ai realitet do të kishte ndryshuar apo jo nën bombardimet intensive, si ato që po shihen këto ditë në mbarë Ukrainën.

Mund të duket e pabesueshme, por arsyeja pse presidenti rus Vladimir Putin ishte i bindur se mund ta fitonte luftën në Ukrainë brenda dy ditësh, dhe të rikthehej në shtëpi pasi të vendoste në Kiev një qeveri kukull, është një raport i shërbimit sekret të brendshëm, FSB, që "fotografoi" një realitetet shoqëror dhe politik shumë të ndryshëm nga ai që është në realitet.

Vendimi për pushtimin e Ukrainës, u mor në bazë të një

investigimi të kryer javët e fundit mbi situatën ekonomike, sociale dhe politike të porositur nga Drejtoria e Nëntë e Shërbimit Federal të Sigurisë (FSB), pra ajo që merret zakonisht me vendet fqinje.

Sipas këtij studimi, në fillimin e muajit shkurtit, një pjesë e madhe e ukrainasve shpreheshin pesimistë për të ardhmen, nuk kishin besim tek politikanët dhe institucionet, dhe ishin të shqetësuar për rritjen e inflacionit dhe koston e jetesës. Puna e presidentit Volodymyr Zelensky pëlqej nga vetëm 27 për qind e qytetarëve. Ndërkohë 67 për qind e ukrainasve shprehin mosbesim ndaj tij, ndryshe nga 68 për qind e tyre që kishin shumë besim tek ushtria ukrainase.

Po ashtu Putinit iu raportua një mungesë e theksuar e besimit tek policia dhe shërbimet e sigurisë së brendshme. Vlerësimi ndaj parlamentit dhe partive politike ishte shumë i keq, me respektivisht 11 për qind dhe 8 për qind. Në fakt, 40 për qind e qytetarëve iu përgjigjën sondazhit se nuk do ta mbronin Ukrainën nëse ajo do të pushtohej.

Shumica kishte besim tek forcat e armatosura në rastin e një

pushtimi, pavarësisht se ato ishin inferiorë ndaj rusëve, gjë për të cilin ukrainasit ishin të vetëdijshëm. 90 për qind e të anketuarve e dinin që Moskë po vendoste një numër të madh trupash dhe armatime në kufi me Ukrainën, por nuk besonin se kjo do të pasohej nga një luftë e vërtetë.

Kishte edhe elementë të tjerë që e mashtruan Kremlinin. Për shembull, më shumë se gjysma e ukrainasve kishin një mendim të mirë për Kishën Ortodokse, pavarësisht se ishte të vetëdijshëm se të qenit e saj si pjesë e Patriarkanës së Moskës, nënkuptonte infiltrimin e shërbimeve sekrete ruse.

Nga pikëpamja rajonale, banorët e Ukrainës Juglindore, ishin ata që kishin shumë më pak besim tek shteti. Të gjitha këto të dhëna ishin edhe baza e fjalimit televiziv të Vladimir Putinit në pragun e pushtimit, kur ai foli për Ukrainën, duke ripërkthuar panoramën që i dha FSB-ja e tij. Në këto kushte, institucionet më të mbështetura nga ukrainasit, si forcat e armatosura, ishin ato kundër të cilave rusët synonin të sulmonin më shpejt dhe me vendosmëri. Por deri më tani gjërat kanë shkuar shumë ndryshe. Rusët e nënvlerësuan

mobilizimin popullor dhe faktin se vetëm në Ukrainën Juglindore, nuk kishte dëshirë për t'u mbrojtur nga një pushtim rus.

Njëkohësisht, analiza e FSB-së paralajmëronte se lufta do të fitohej edhe humbej në Kiev, dhe se forcat speciale do të goditnin fort organizatat e mbrojtjes civile. Me pak fjalë, thekson raporti i think-tankut britanik, cilido që e planifikoi pushtimin e mori seriozisht atë dokument të FSB-së, duke e bindur veten se Rusia do të kishte një shans të mirë për të shkatërruar shumë shpejt institucionet ukrainase.

Po ashtu mendohej se Moskë do t'i bindte shpejt ukrainasit se mund të ofronte për një adresim më të mirë të problemit të korrupsionit, pavarësisht se ky është një problem endemik në Rusi, përveç varfërimit të dukshëm të territoreve të Donetskut dhe Luganskut që nga viti 2014.

Prandaj, edhe nëse FSB-ja kishte të gjitha të dhënat për ndryshimet sociale dhe për opinionin e qytetarëve ukrainas që nga viti 2006, ajo nuk ka marrë parasysh se sa do të kishte ndikuar një ndryshim epokal, siç është një pushtim u huaj.

Sulmet ajrore, të cilat Putini nuk i ka shfrytëzuar masivisht deri më

tani, perceptohen negativisht, edhe nëse do të synonin vetëm objektiva ushtarakë. Pasojat janë urrejtja ndaj atyre që sulmojnë, dhe një rezistencë akoma më e fortë.

Pjesë e punës së shërbimeve sekrete, është edhe hedhja e hipotezave mbi pasojat e një veprimi, dhe dhënia e këshillave më të mira për "vendimmarrësit politikë". Por një gjë ishte situata në kohën e këtij investigimi, dhe krejtësisht tjetër gjë situata pas pushtimit.

Me sa duket, edhe Drejtoria e Nëntë e FSB-së e kufizoi veten tek hedhja në letër e gjendjes shpirtërore të banorëve në lindje të lumit Dnieper, pa marrë parasysh se si ndiheshin ukrainasit e tjerë në përditë të këtij lumi dhe në kryeqytetin Kiev.

Këto gafa të mëdha në planifikimin paraprak të sulmit, po e vendosin Putinin në vështirësi të mëdha. Dhe autorët e raportit të RUSI, shkruajnë se udhëheqësi rus mund të kalojë nga premtimi për qeverisje të mirë në një shtypje të pamëshirshme. Raporti në fjalë titullohet "Ukraina përmes syve të Rusisë". Mesa duket drejtuesit e FSB duhet të ndryshojnë okulistin.


EURO GLASS
SAINT-DISAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Rrahmani para ndeshjes ndaj Milanit: Duam të mbahemi mend si heronj



NAPOLI, 3 MARS - "Duam të mbahemi mend si heronj". Mbrojtësi i Napolit, Amir Rrahmani, ka dashur ta motivojë Napolin në pritje të ndeshjes për titull kundër Milanit, që do të luhet të dielën në stadiumin Maradona, një rast që duhet shfrytëzuar në maksimum në luftën për titull. Si trajneri Spalletti, ashtu edhe mbrojtësi Rrahmani, nuk kanë dashur të zbalancohen në lidhje me luftën për titull. "Nuk duam ta përmendim akoma fjalën titull

sepse jemi të vetëdijshëm se është akoma herët për të folur për këtë. Tifozëve u them se edhe ne si ata kemi një ëndërr dhe një objektivi të madh për të arritur. Dhe fakti që kemi një javë në dispozicion për t'u përgatitur mund të jetë një gjë pozitive për ne. Duam të mbahemi mend si heronj, siç ka thënë Spalletti. Do ta provojmë deri në fund", ka thënë Rrahmani për radion "Kiss Kiss Napoli". Skuadra e Amir Rrahmanit, Napoli, kryeson Serinë A me pikë të barabarta me Milanin dhe të

dielën do të provojë të fitojë dhe ta nisë arratisjen. "Me Milanin do të provojmë të mos pësojmë gola. Ky është një objektivi thelbësor për ne mbrojtësit dhe për portierin. Me Lazion ka qenë një fitore e rëndësishme për të vazhduar të qëndrojmë lart në renditje. Të gjitha ndeshjet janë të rëndësishme tani dhe mund të jenë 4/5 skuadra në luftë për titullin. Edhe Atalanta me Juventusin mund të hyjnë në garë. Gjithçka mund të ndodhë", ka shtuar Ancelotti.

Kuka: Koha për t'u dhënë përgjegjësi trajnerëve të tjerë

PEJË, 3 MARS - Trajneri i xhudos, Driton Kuka, ka lënë të kuptohet se po përgatitet për t'u hapur rrugë trajnerëve të tjerë në xhudo. Ai nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka bërë me dije se çmimi i trajnerit më të mirë në botë

për vitin 2021 ishte kurora e të arriturave të tij në këtë sport. "Ndarja e titullit për trajnerin e vitit 2021 në Botë është kurora e të arriturave për mua si trajner në sport", ka thënë Kuka i cili ka fituar medalje të arta olimpike, po ashtu të arta

ka fituar edhe në kampionate botërore dhe evropiane. "Koha me u dhanë përgjegjësi trajnerëve të tjerëve nga sporti i xhudos, por edhe sporte të tjera. Majlinda si sportiste ka vendosur standarde të larta për çdo sportist, e unë

Majlindës në rrugën e saj si trajner. Sfidat janë që e bëjnë sportin e bukur dhe joshës, por sfidat për medalje e rezultate serioze e jo me përralla e rezultate të dyshimta e mashtruese", ka shtuar Kuka.



SHKURT

KB Trepça përforcohet me ish-lojtarin e NBA-së

KB Trepça është përforcuar me ish-basketbollistin e NBA-s, Rodney Pursiv. Klubi nga Mitrovica e ka paraqitur Pursivin të enjten në faqen e tyre zyrtare në "Facebook". 28-vjeçari në vitin 2018 ka luajtur në NBA sa ishte pjesë e Orlando Magic. Në Orlando pati një mesatare prej 6 pikësh të shënuara dhe 1.1 asistime. Karrierë ka bërë edhe te disa skuadra të ndryshme. Së fundi ishte pjesë e ekipit ukrainas Cherkaski Mavpy. Ai ka qenë i përfshirë më herët edhe në kampin e Përfaqësueses së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Shevchenko: Futbollli nuk ekziston më për mua

Sulmuesi legjendar i AC Milan dhe Kombëtares së Ukrainës, Andriy Shevchenko, ka bërë thirrje për dërgimin e ndihmave për viktimat në atdheun e tij. "Ne kemi refugjatë, kemi nevojë për ndihmë humanitare. Ne kemi nevojë për ndihmë mjekësore, ndihmë ushqimore", ka thënë Shevchenko, i cili ka luajtur 111 ndeshje për ekipin kombëtar të Ukrainës dhe ka shënuar 48 gola. "Futbollli nuk ekziston më për mua. Unë nuk mendoj për të. Nuk është koha për këtë. Unë jam i përqendruar. Sapo zgjohem mendoj si ta ndihmoj vendin tim, çfarë mund të bëj për të", ka shtuar Shevchenko.

Strakosha ende i pavendosur, Lazio në listë ka tre portierë

E ardhmja e Thomas Strakosshës po shndërrohet në telenovelë. Lazio po shkon drejt një fundsezonei ku të dy portierët mund të largohen falas. Prioritet kryesor mbetet portieri shqiptar. Tare dhe Lotito po bëjnë gjithçka për ta bindur, por firma mbi kontratë mbetet ende shumë larg. Strakosha nuk është i bindur plotësisht, por në këtë të sezon drejtuesit e Lazio po rrezikojnë shumë. Në të njëjtën situatë është edhe Reina, por me portierin spanjoll mund të rinovojë automatikisht nëse arrin të kualifikohet në Evropë. Në kushtet ku Strakosha nuk ka vendosur ende dhe në kushtet kur Reina nuk ofron garanci, Tare është i detyruar ta studiojë treguan. Në listën e tij gjejmë emra si Sergio Rico, Gollini, ndërsa ëndërr mbetet Kepa i Chelseat.

Tri pista hedhin kandidaturën për ta zëvendësuar garën e Rusisë

PORTIMAO, 3 MARS - Pas vendimit që mori Federata Ndërkombëtare e Automobilizmit (FIA) për anulimin e garës së Rusisë në Formula 1, në pistën e Sochit, ka nisur "gara" për të gjetur një pistë për ta

zëvendësuar. Në "pole" duket gara e Çmimit të Madh të Portugalisë, në pistën e Portimaos, por ka një problem. Gara e Sochit (24 shtator) ishte planifikuar të zhvillohej një javë para garës së Singaporit, duke

parë afërsinë gjeografike, ndërsa pista portugeze është shumë larg, duke sjell probleme logjistike në lëvizjen e skuadrave. Për pasojë, po shihet mundësia që kjo garë të zhvillohet në Stamboll (Turqi) apo Doha

(Katar). Këto dy pista janë më pranë Singaporit dhe vitin e kaluar kanë qenë "pista zëvendësuese", të futura në kalendar nga Formula 1 për shkak të pandemisë dhe anulimit të disa garave.



Veliu: E dua titullin e kampionit me Llapin

PRISHTINE, 3 MARS - Sulmuesi i talentuar i Llapit, Valmir Veliu, është lojtari më i mirë i momentit në BKT Superligën e Kosovës, duke udhëhequr klubin "Zahir Pajaziti" drejt fitoreve dhe rezultateve pozitive në kampionat dhe Kupën e Kosovës. Për formën e tij, objektivat dhe thashethemet e transferimit, Veliu ka folur në një intervistë për "Telegrafin". Llapit e ka nisur sezonin pranveror në mënyrë të përkryer duke aritur tri fitore dhe një barazim në kampionat, teksa ka kaluar edhe në çerekfinale të Kupës së Kosovës, pasi ka eliminuar Ferizajin.



Një nga lojtarët më meritore në këtë nisje të sezonit pranveror pa dyshim se është edhe sulmuesi 21-vjeçar Valmir Veliu. Veliu ka qenë vendimtar me golat dhe asistimet e tij këtë sezon, në veçanti në ndeshjet e pranverës, duke shënuar në udhëtimin te Drita në barazimin 1-1 dhe dy gola të tjerë në fitoren 3-0 ndaj Malishevës. Repreruesi i Kosovës U-21 gjithashtu ka asistuar në fitoren 0-2 ndaj Ferizajt në Kupën e Kosovës dhe fitoren 2-0 ndaj Ulpianës në Superligë. "Po, jam duke kaluar në formë të mirë. Edhe objektivat individuale janë që t'i ndihmoj ekipit për arrijtjen e objektivit që është dalja në Evropë

dhe pse jo edhe titullin kampion në Superligën e Kosovës", ka thënë fillimisht Veliu, i cili më pas ka folur edhe për objektivat personale, duke thënë se dëshira e tij është t'i ndihmojë skuadrës së Llapit në rrugën drejt përmbushjes së objektivit. "Me këtë formë, mendoj që të shënoj më shumë gola që t'i ndihmoj ekipit për t'i arritur objektivat që kemi së bashku. Numri i golave për mua nuk ka rëndësi", ka shtuar ai.

Veliu nuk është duke menduar momentalisht për të ardhmen, pasi është i fokusuar në skuadrën nga Podujeva. "Transferimi? Për

momentin jam i fokusuar vetëm te Llapit që ta jap maksimumin dhe, sa iu përket ofertave, do ta shohim në fund të kampionatit me kompaninë time menaxheriale KA Sportmenagement. Kampionati i preferuar? Nuk ka rëndësi kampionati se ku dua të luaj, pasi të gjitha janë në nivel të lartë, por normalisht me punë mund të arrihet gjithçka", ka deklaruar Veliu. Në këtë sezon Veliu ka zhvilluar 19 ndeshje në BKT Superligën e Kosovës, duke shënuar 8 gola dhe 6 asistime, ndërsa në të gjitha garat 21-vjeçari ka 23 paraqitje, duke shënuar 9 gola dhe 8 asistime.

SHKURT

Regjistrohet viktima e katërt nga sporti në Ukrainë

Federata e Çiklizmit Ukrainas ka njoftuar për vdekjen e Alexander Kulyk, trajneri i çiklizmit dhe babai i kampionit ukrainas të çiklizmit të vitit 2019, Andriy Kulyk. "Ai ishte në një operacion ushtarak për t'i larguar njerëzit nga qyteti i Kievit. Kulyk ishte trajner i federatës prej një kohe të gjatë. Më parë e kishte ushtruar profesionin e trajnerin e Bashkimit Sovjetik dhe ekipeve ruse. Andriy ishte duke u stërvitur kur babai u vra. Në federatë e morëm vesh para djalit vdekjen e babait të tij", ka thënë Grivko, bashkatdhetari i të ndjerit. Me të tashmë janë katër vdekje në botën e sportit nga lufta në Ukrainë. Si pasojë e bombardimeve ruse kanë humbur jetën dy futbollistë, Vitalii Sapylo dhe Dmytro Martynenko, si dhe një biathlet, Yehven Malyshev.

Yamolenko: Po vriten njerëz në vendin tim, momenti ta ndalim këtë marrëzi


Ylli i West Hamit, Andriy Yarmolenko, ka reaguar ashpër për luftën që po zhvillohet në Ukrainë, në vendin e tij. Me anë të një postimi në rrjetet sociale, ai ka kërkuar reagim nga të gjithë për këtë masakër që po zhvillohet. "Jam Andriy Yarmolenko, përfaqësues ukrainas. Jam lindur në St Petersburg, por jam rritur në Ukrainë dhe e konsideroj veten 100 për qind ukrainas. E kam një pyetje për sportistët rusë. Djelmasha, përse jeni ulur si të çmendur dhe nuk thoni asgjë? Në vendin tim po vriten njerëz, po vriten gra, po vriten nëna, po vriten fëmijët tanë. Mirëpo ju, nuk po thoni asgjë, nuk keni komente", ka thënë Yamolenko. "Ju lutem, e dini se çfarë do të ndodhë nëse të gjithë ju u demonstroni njerëzve se çfarë realisht po ndodh në vendin tim. I njoh shumë prej jush dhe të gjithë më keni thënë 'nuk duhet të ndodhte kështu'. Ju e dini se presidenti juaj po silltet në mënyrë të tmerrshme. Ju e keni influencën e njerëzve, ju lutem. Tani është momenti demonstroni forcën tuaj. Faleminderit për vëmendjen! Lavdi Ukrainës!", ka shtuar Yamolenko.

Verstappeni rinovon me Red Bullin

Ashtu sikurse pritej, Max Verstappen ka rinovuar kontratën me Red Bullin deri në vitin 2028. Kontrata e mëparshme skadon në fund të vitit 2023. Piloti holandez do të qëndrojë me Red Bullin edhe për pesë sezone të tjera. Red Bullin nuk ka publikuar rrogën e pilotit që, sipas medieve holandeze, do të arkëtojë rreth 36 milionë euro në sezon. Pra, një investim me vlerën e 200 milionë eurove për Red Bullin për ta mbajtur kampionin e botës në Formula 1. "Adhuroj të jem pjesë e Red Bullit, ndaj vendimi për të qëndruar me këtë skuadër deri në vitin 2028 ishte mjaft i lehtë. Viti 2021 ishte i jashtëzakonshëm, duke arritur objektivin që kishim vënë që prej vitit 2016", ka thënë Verstappen. "Objektivi i ri është të qëndrojmë në majë sa më gjatë të jetë e mundur", ka thënë piloti. Ndërsa shefi i Red Bullit, Christian Horner, ka deklaruar: "Kontrata e re tregon se ne besojmë te njëri-tjetri. Max është pjesë e projektit tonë afatgjatë".

Phoenixi bën ligjin në NBA

Phoenix, 3 mars - Phoenixi bëhet skuadra e parë në NBA që arrin kuotën e 50 fitoreve këtë sezon (ka edhe 12 humbje). Suns mposhti me rezultat 120-90 Portland, një fitore kolektive, ku realizuan plot 12 lojtarë të skuadrës vendase. Fitore në sekondat e fundit arrin



Milwaukee, që mundi 120-119 Miamin, në një ndeshje me rivalitet. Herro realizoi 30 pikë për Miamin, por që mbetën për

statistikë, ndërsa për Bucksin u dalluan Antetokounmpo (28 pikë e 17 rebounde), Middletoni (26 pikë) e Holiday (25 pikë e 11 asistime). Pas kohës shtesë fiton Utah Jazzi, që mundi 132-127 Houstonin jashtë fushës, ndeshje ku u dalluan Mitchell me 37 pikë e Goberti me 27 pikë. Moment të mirë po kalon Philadelphia, që mundi 123-108 New Yorkun, duke synuar kreun në Lindje. Embiid realizoi 27 pikë e 11 rebounde, Hardeni 26 pikë e Maxey 25, një trio që po bën të ëndërojnë tifozët e këtij ekipi. Befason Oklahoma, që falë 29 pikëve të Shait mposhti 119-107 Denverin jashtë fushës.

REZULTATET

Cleveland - Charlotte	98-119
Orlando - Indiana	114-122
Philadelphia - New York	123-108
Houston - Utah Jazz	127-132
Milwaukee - Miami	120-119
New Orleans - Sacramento	125-95
Denver - Oklahoma	107-119
Phoenix - Portland	120-90

Allegri: Fiorentina nuk e meritoi humbjen

Skuadra e Juventusit ka marrë një fitore shumë të rëndësishme në udhëtim te Fiorentina në kuadër të ndeshjes së parë gjysmëfinale në Coppa Italia. Fituesin e vulosi autogoli në minutën e fundit nga Venutti. Trajneri i Juventusit, Massimiliano

Allegri, është shprehur i kënaqur me këtë fitore. "Ne i dinim vështirësitë që na prisnin në Firenze dhe për të luajtur këtë ndeshje. Ndeshja ishte e ekuilibruar dhe kishim situata në të cilat nuk përfunduam pasimin e fundit, por djemtë ishin të mirë dhe

sinqerisht kjo ndeshje ishte e vështirë, rrezikuam në fushë të hapur, por luajtëm me qetësi. Rezultati 1-0 për ne është rezultat i mirë që na bën të lumtur", ka thënë Allegri, i cili më pas e ka lavdëruar paraqitjen e Fiorentinës. "Jo, nuk më befaso! aspak Fiorentina.

Ne e dimë që luan përpara dhe që ka aftësi të shkëlqyer teknike. Italiano po bën një punë të shkëlqyer. Ai është shumë i mirë. Gjë e mirë që e kemi rezultatin në anën tonë, por Fiorentina sigurisht që nuk e meritonte të humbiste", ka shtuar Allegri.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Dorëzimi i raportit për transaksionet e kontrolluara për vitin 2021

Të nderuar tatimpagues,

Bazuar në Legjislacionin Tatimor, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ MF-Nr. 02/2017 për Transferim të Çmimit, afati për dorëzimin e formës "Njoftimi i transaksioneve vjetore të kontrolluara" për vitin 2021 është deri me datë 31 mars 2022.

Tatimpaguesit e përfshirë në transaksione të kontrolluara në mes të personave të lidhur, që janë subjekte të juridiksioneve të ndryshme tatimore, të cilët brenda periudhës raportuese në total kalojnë shumën prej treqind mijë euro (300,000€) janë të obliguar të dorëzojnë formën "Njoftimi i transaksioneve vjetore të kontrolluara".

Raportimi të bëhet për transaksionet e kontrolluara të vitit 2021. Ky njoftim duhet të dorëzohet në formë fizike në:

Zyrën Qendrore të Administratës Tatimore të Kosovës / Divizionin për Transfer të Çmimit.

Adresa: Këndi i rrugëve "Dëshmorët e Kombit" dhe "Bill Klinton", Prishtinë.


Për çdo paqartësi, ju lutemi na kontaktoni në:

Tel: 038 200 250 94 ose E-mail: transferpricing@atk-ks.org

Formularin "Njoftimi i transaksioneve vjetore të kontrolluara" mund ta gjeni në web-faqen e ATK, www.atk-ks.org - Publikime - Dokumente.

ATK mban premimin për kujdesin e vazhdueshëm ndaj tatimpaguesve!

Administrata Tatimore e Kosovës



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM ZBRITJE MALLI DERI 75 %

Biznesi individual me numër Unik Identifikues 810497398 me seli në Llapna Sell dhe nr. kontakti 044777778, për arsye të likuiditetit, njofton të interesuarit qytetarë si persona fizik apo juridik mund të blejnë produkte kozmetike grimi të brendeve botërore MAX FACTOR, ARTDECO, parfuma, deodorante, qumësht trupi etj, të firmave botërore BOSS, BALDESSARINI, D&G, Lacoste, Moschino, Valentino, Versace, ngjyra flokësh, pajisje tretmani dhe mirëmbajtje floku të prodhuesit Italian DIKSON.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Euro Loli-D- SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330224296.

▶ Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

